



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

PËR

RREGULLOREN NR. X/2023

PËR PUNËN E PANELIT PËR LIRIM ME KUSHT

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Projekt Rregullore Nr. X/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht synon të vendosë procedura të qarta dhe gjithëpërfshirëse për punën e Panelit për Lirim me Kusht në shqyrtimin dhe vendimmarrjen për kërkesat e personave të dënuar për lirim me kusht.

Rregullorja përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Panelit, kompetencat dhe procedurat e zbatimit nga Institucionet Korrektuese dhe Shërbimi Sprovues, parashtrimin e kërkesave për lirim me kusht nga të dënuarit, shqyrtimin e kërkesave për lirim me kusht, faktorët që merren parasysh në vendimmarrje, përmbajtjen e vendimeve, si dhe procedurat për mbikëqytjen e të liruave me kusht dhe rastet e revokimit të lirimimit me kusht.

	<p>Kjo rregullore synon të sigurojë transparencë dhe kuptim për të gjithë pjesëmarrësit në procesin e lirimit me kusht dhe përcakton udhëzimet e nevojshme për zbatimin e rregullores.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Arsyeja e hartimit të kësaj projekt Rregullore janë ndryshimet ligjore, përkatësisht miratimi i ligjit të ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i cili e ka bërë të domosdoshme rishikimin e rregullores aktuale në fuqi si dhe qëllimi i Këshillit për përmirësimin e boshllëqeve procedurale dhe ofrimi i udhëzimeve më të detajuara për Panelin, Institucionet Korrektuese dhe Shërbimin Sprovues në përmbushjen e detyrave të tyre.</p> <p>Synim kryesor i kësaj projekt rregullore është të promovojë edhe rehabilitimin dhe ri-integrimin e suksesshëm të individëve të dënuar për vepra penale</p> <p>Kjo projekt rregullore përcakton afate më të shkurtra kohore për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për lirim me kusht, gjë që rrit efikasitetin e procesit, duke avancuar efikasitetin, efektivitetin dhe besueshmërinë në sistem.</p> <p>Forcon të drejtat e personave të dënuar në procesin e lirimit me kusht përmes transparencës dhe informimit.</p> <p>Siguron objektivitet dhe konsistencë më të madhe në shqyrtimin e kërkesave nga Paneli përmes kriterëve dhe procedurave të qarta.</p>

	<p>Modernizon dhe shpërfaq dispozita në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare të drejtësisë.</p> <p>Rrit llogaridhënien e institucioneve përmes raportimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të draft Rregulloren Nr. X/2023 Për Punën e Panelit për Lirim me Kusht.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 6 dhjetor 2023.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>